

Qebir Avziu, PhD<sup>1</sup>

UDC:  
343.143/.144

**TAKTIKA DHE TEKNIKA PËR SIGURIMIN E INTERVISTËS ME  
PERSONIN E DYSHUAR DHE DËSHMITARIN**

**ТАКТИКА И ТЕХНИКА НА ОБЕЗБЕДУВАЊЕ ИНТЕРВЈУ СО  
ОСОМНИЧЕНО ЛИЦЕ И СВЕДОК**

**TACTICS AND TECHNIQUE TO PROVIDE INTERVIE WITH  
SUSPECTED PERSON AND WITNESSES**

**Abstract**

Successful effort against crime is impossible unless we are not using police interrogation measures (otherwise known as informational conversation). By informational conversation we mean informal gathering data from citizens within operative activities. This definition means that we are dealing with actions undertaken by ones that have authorization to undertake them (Police, Customs Administration and Financial Police) with self initiative in all stages of criminal proceedings. The informal nature of the act, without evidence value, but is very important for the further procedure and the results of this procedure. Information collected from citizens in two phases of operational activity: control and forensic processing. Giving statements subsequent in the criminal proceedings represents repetition of what has previously been said to the police, where this statement would not be evidence until the same is not declared before the judge. Pose the question why such a statement should not be used as evidence, if such a statement would be taken in conformity with legal regulations done in details. This

---

<sup>1</sup> Professor at the Law faculty of University of Tetovo.

practice is known in many Western European countries, USA, UK, Germany etc, where statements are given in front of the police and are recorded. The study will make also a comparative analysis approach to the question of legal regulation of questioning (**interviews**) with citizens by the police of some European countries.

**Keywords:** questioning, interview, crime, statement, police

## TAKTIKA DHE TEKNIKA E PYETJES SË TË PANDEHURIT DHE DËSHMITARËVE

### 1. E vërteta dhe gënjeshtra

Nevoja për të zbuluar gënjeshtërën nuk është ndonjë dukuri e re, ajo daton që kur njeriu dinë për vetveten. Njerëzimi gjithmonë kanë bërë përpjekje që të mund të dallojë ata të cilët gënjejnë dhe ata që nuk gënjejnë, atyre që mund t'u besohet dhe atyre që nuk mund t'u besohet.

Në këtë drejtim njeriu përveç torturës, ka bërë edhe përpjekje të mëdha, duke konstruktuar makina të ndryshme të cilët do të ishin në gjendje të zbulojnë gënjeshtërën. Mandej ka prodhuar edhe ilaçe që të ndikojë tek vullneti i personit për të treguar të vërtetën. Duhet të pajtohemi me faktin se të gjithë, të paktën njëherë në jetën tonë kemi gënjyer, mandej nuk mund të mohojmë se gënjeshtra nuk zë edhe një vend të rëndësishëm në jetën tonë. Sigurisht që na kujtohen momentet kur prindërit dhe mësuesit na mësonin që gjithmonë të jemi të drejtë e të ndershëm dhe asnjëherë të mos gënjejmë. Por sado që të mundohemi të jemi të drejtë dhe të sinqertë, përsëri në rrethana të caktuara mund të gënjejmë, kështu të paramendojmë momentin kur shkojmë në spital ta vizitojmë një mik i cili vuan nga kanceri dhe duket shumë i sëmurë, ai është në fazën e fundit të jetës, por ne sigurisht se do t'i themi se duket shumë mirë dhe se së shpejti do të shërohet edhe pse e dimë se ai së shpejti do të vdes. Në këtë kontekst, ne të gjithë gënjejmë, por kjo lloj e gënjeshtërës njihet si *gënjeshtra e bardhë* dhe shoqëria nuk pëson asnjë dëm nga kjo.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Nathan, G. & William, F., (2002), *Effective interviewing and interrogation techniques*, Sarajevë, f.12.

Kategoria e dytë e gënjeshtërisë është *gënjeshtria e zezë*, e cila ka për qëllim dëmtimin e të tjerëve dhe mbrojtjen e interesit individual. Sidoqoftë edhe gënjeshtria nuk është lehtë të sajohet, sepse autori duhet të harxhoj shumë energji mendore duke imagjinuar e ngritur rrethana të cilët vërtet nuk ekzistojnë dhe të cilët duhet të jenë rezistuese ndaj së vërtetës.

Pastaj duhet të kemi parasysh se personi humb shumë kohë derisa e gërsheton një gënjeshtër, ai disa herë ngritë një version i cili pastaj i duket pak i besueshëm dhe fillon të ngritë tjetrin, derisa sipas bindjes së tij ka arritur të krijojë një gënjeshtër që është e besueshme. Në krahasim me këtë, shumë më lehtë e ka personi i cili e tregon të vërtetën, truri tij punon shumë i qetë, sepse vetëm i riprodhon ato rrethana që realisht janë regjistruar në tru, prandaj në këto raste nuk ka nevojë të krijohet diçka që nuk përkon me realitetin, prandaj njeriu as nuk djersitet. Por duhet të dihet se nuk ka gënjeshtër që është e përsosur, kjo është kështu sepse nuk ka njeri të përsosur, në çdo gënjeshtër ka zbrazëtirë, prandaj zotësia e hetuesit është nëse ai mund të vërejë këto zbrazëtira dhe ta dalloj të vërtetën nga gënjeshtria. Për shembull, bashkëshorti i telefonon gruas dhe i thotë se atij papritmas i kishin dalë shumë punë dhe patjetër duhet t'i përfundonte, andaj nuk do të mund të vinte në shtëpi për drekë në ora 16:00 kur edhe zakonisht e përfundon orarin e punës. Pastaj i tregon se më vonë do ta bënte një pauzë për të ngrënë drekë dhe përsëri do të kthehej në punë. Ashtu edhe bën, punon më gjatë se orari i zakonshëm, deri ora 17:00, pastaj takohet me të dashurën dhe së bashku shkojnë në hotel, hanë drekë dhe qëndrojnë deri në ora 21:00. Pas kësaj përsëri kthehet në zyrë dhe në ora 22:00 mbërrin i lodhur në shtëpi.

Personi asgjë nuk e ka gënjyer të shoqen, ka punuar më shumë se orari i zakonshëm, ka bërë pauzë, ashtu siç i kishte thënë gruas, kthehet në zyrë dhe në fund i lodhur mbërrin në shtëpi. Por, hetuesi i mirë, në mes rreshtave duhet të dallojë se cilat rrethana janë të vërteta dhe cilat janë gënjeshtria.

## **2. Përgatitja për zhvillimin e bisedave**

Pavarësisht se me cilin zhvillohet biseda, hetuesi duhet ta marrë me seriozitet dhe të përgatitet për të zhvilluar bisedën që ajo të jetë sa më efikase. Biseda e *shpejtë* dhe pa përgatitje paraprake është e dëmshme,

aço nuk jep rezultate të mira, prandaj fillimisht hetuesi në mënyrë të kujdesshme krijon një plan që përmban disa pika bazë (koncept mbi pyetjet) mbi zhvillimin e bisedave që kanë të bëjnë me rrethana relevante të çështjes penale.

Po ashtu hetuesi kujdeset edhe për vendin ku do të zhvillohet biseda, është mirë që në atë vend (zyrë) të krijohet një ambient i qetë, të mos ketë shumë njerëz apo hetues nga departamentet e ndryshme, siç është praktikë në vendet tona. Në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që i dyshuari apo dëshmitari të presë në korridor, deri sa hetuesit të pinë kafe në zyrë. Në rastet kur i dyshuari i thirrur (apo i arrestuar) ose dëshmitari arrin në vendin ku do të zhvillohet biseda, hetuesi duhet në mënyrë njerëzore të përshëndetet dhe ta ftoj të ulet. Pas kësaj menjëherë i ofron ndonjë kafe apo ndonjë lëng. Është gabim i madh nëse hetuesi fillon menjëherë bisedat lidhur me çështjen penale, sepse kështu mund të krijoj përshtypje sidomos te dëshmitari se biseda duhet të zhvillohet shpejt e shpejt, me urgjencë, për të cilën gjë është i interesuar edhe vet dëshmitari. Në këtë mënyrë shumica e bisedave përfundojnë pa sukses. Prandaj fillimisht hetuesi duhet të relaksojë bashkëbiseduesin, duke tentuar që të gjejë tema të lira nga jeta e përditshme (sport, film, muzikë etj.), kuptohet tema që janë me interes për personin.

Është mirë që hetuesi paraprakisht të ketë rregulluar zyrën, ashtu që te personi të mbetet përshtypja e një institucioni serioz. Në asnjë mënyrë nuk duhet të bëjë lëvizje me trup, me dorë, me këmbë, të prek flokët, teshat etj., por duhet të qëndrojë drejt dhe i qetë, kështu përfitohet besueshmëria dhe bindja.

Ajo që është jetike dhe që ka peshë të madhe gjatë zhvillimit të bisedës dhe që vërtet pak i kushtohet rëndësi, është veshja e hetuesit. Praktika shumë qartë tregon se hetuesi i veshur me kostum duket shumë më serioz, krahasuar me hetuesin e veshur me xhinse, rezultatet janë të padiskutueshme. Mandej edhe në jetën e përditshme, ne jemi më të kujdesshëm më shumë ndaj personave me kostum dhe kravatë, krahasuar me të tjerët sepse ata më së shumti nxisin *besimin* e publikut në dinjitetin, integritetin dhe ndershmërinë e tyre. Veshja edhe pse paraqet aspektin formal, përsëri është e një rëndësie jetike dhe ka ndikim të madh te personat me të cilët zhvillohet biseda. Veshja me kostum dhe kravatë ka edhe kuptimin e uniformës për hetuesit civil. Nuk është mirë që gjatë zhvillimit të bisedës, hetuesi të ulet mbi tavolinë, ta nxjerrë celularin dhe vazhdimisht të shkruaje mesazhe duke mos i kushtuar

rëndësi bashkëbiseduesit. Nuk mund të lejohet që hetuesi t'i ngritë këmbët mbi tavolinë apo të tregojë shenja tjera të lodhjes, siç mund të vërehet nëpër filmat holivudian.

### 3. Kushtet që duhet plotësuar hetuesi

Fillimisht hetuesi duhet të njoh normat ligjore, njohje e cila do t'i mundësojë inspektorit që gjatë zhvillimit të bisedës, të mos dalë jashtë kornizave ligjore. Njohja e normave ligjore, po ashtu do të ndihmojë punëtorët përgjegjës për zbatimin e ligjit, që të formulojnë pyetje që orientohen drejt fakteve relevante, si dhe të mos parashtrojë pyetje të pavlefshme.

*Njohja e personalitetit të të dyshuarit.* Me këtë nuk nënkuptohet që hetuesi të grumbullojë të dhëna vetëm nga evidencat policore lidhur me veprimtarinë apo karrierën kriminale (recidivizmin) në të kaluarën, por në rend të parë nënkuptohet edhe njohja e rrethanave të ndryshme siç janë tiparet e karakterit, temperamentit,<sup>3</sup> arsimimi, kultura etj. sepse vepra penale është pasqyra e personalitetit të kryerësit e manifestuar në botën e jashtme. Sigurisht që biseda do të zhvillohet në një nivel më të

<sup>3</sup> Filozofi grek Hipokrati, dallonte katër tipe personash që i klasifikonte në bazë të temperamentit, edhe atë: tipi kolerik, sanguinik, flegmatik dhe melankolik. *Tipi kolerik* është ai person i cili reagon shpejt, në mënyrë të vrullshme, me nderja dhe emocione të fuqishme, i cili për gjëra të imta e të vogla bie në konflikt me personat tjerë. Këta tipa zemërohen e hidhërohen shpejt dhe kjo gjendje e hidhërimit manifestohet një kohë të gjatë dhe haptas. *Tipi sanguinik* po ashtu reagon shpejt dhe me vrull, shpejt vjen në gjendje të afektit. Por te këta persona, intensiteti i emocioneve bie brenda një periudhe të shkurtër kohore. Kështu që për dallim nga tipi kolerik, i cili nuk heq dorë nga qëndrimet e veta, tipi sanguinik menjëherë i bie pishmanit, duke thënë se u ka ra terri syve. *Tipi flegmatik* është tip që reagon ngadalë dhe rrallë shqetësohet, kurse emocionet te këta tipa janë të dobëta dhe thuaj se aspak nuk manifestohen. Këta persona në jetën e tyre janë të qetë, stabil dhe të matur, për ata thuhet se kanë nerva të forta dhe nuk reagojnë për sende të imta, me një fjalë janë gjakftohtë. Ky tip kur kryen vepra penale atëherë veprimet e tyre kriminale në të shumtën e rasteve janë të paramenduara dhe nuk ndjen ndonjë përgjegjësi morale për aktet e mizorisë që mund t'i shkaktojë. *Tipi melankolik* këta persona janë introvertë dhe të tërhequr në vetvete. Ata duken shumë të pikëlluar, të padisponuar dhe nuk u interesojnë lëvizjet që ndodhin në botën e jashtme, para tyre. Por te këta persona ndonjëherë mund të vijë edhe çrregullim emocional, në këto raste personat karakterizohen me emocione të fuqishme si lumi dhe janë të pakontrollueshëm, prandaj në këto rrethana mund të kryejnë edhe krime të rënda.

lartë, kur para hetuesit qëndron një intelektual dhe ndryshe kur është fjala për një person që nuk është i arsimuar.

*Analizimi i materialit operativ.* Hetuesi para se të fillojë bisedën, hollësisht duhet të njihet me materialin operativ që është grumbulluar gjatë kontrollit dhe përpunimit kriminalistik.

Në zhvillimin e bisedave, kurrë nuk duhet marrë pjesë hetuesi i cili nuk ka njohuri me faktet që janë siguruar deri në atë moment, mbi ngjarjen penale. Në praktikë është vërejtur se, në rastet kur bisedën e ka zhvilluar hetuesi i papërgatitur, pa mos u njohur mirë me çështjen penale, dëshmitari dhe i dyshuari kanë sens natyror dhe menjëherë e nuhatin se hetuesi është i papërgatitur, se nuk ka informacione mbi ngjarjen, prandaj këto biseda përfundojnë si të pasuksesshme.

*Hartimi i planit.* Që biseda të jetë e suksesshme, hetuesi duhet të hartojë një plan ku do të bëjë konceptin e pyetjeve. Këtu duhet të formulohen pyetjet që kanë të bëjnë me faktet dhe rrethanat që duhet sqaruar si dhe pyetjet që kanë të bëjnë me provat dhe faktet që organi i ka grumbulluar, të cilat në mënyrë graduale mund t'i tregohen personit, me qëllim të kapitullimit të shpejtë gjatë bisedës etj.

*Biseda zhvillohet sy më sy.* Shpeshherë parashtrohet pyetja se si është më mirë të zhvillohen bisedat, të jetë i pranueshëm në zyrë vetëm një hetues apo më shumë hetues. Këtu mendimet në mes autorëve ndryshojnë, disa janë të mendimit se kur bisedohet me dëshmitarin dhe viktimën, më mirë është që në zyrë të jetë vetëm një hetues, ndërsa të tjerët mendojnë se duhet të ketë më shumë hetues dhe këtë e arsyejnë me faktin se një hetues duhet të bisedojë, kurse tjetri duhet të marrë shënime dhe të regjistrojë gjithë atë që thotë dëshmitari. Nga praktika kemi vërejtur se marrja e shënimeve gjatë zhvillimit të bisedave, ndikon negativisht mbi dëshmitarin, prandaj është më mirë të mos merren shënime deri sa zhvillohet biseda. Hetuesi gjatë gjithë kohës duhet me kujdes të dëgjojë atë që thotë dëshmitari.

#### **4. Pyetja e dëshmitarit**

Dëshmitari është person nga i cili ekziston besueshmëria se do të japë të dhëna të rëndësishme për veprën penale, kryerësin dhe për rrethana tjera relevante që kanë të bëjnë me çështjen penale. Këtu është fjala për personin i cili nëpërmjet të shqisave të pamurit apo të dëgjuarit drejtpërdrejt ose tërthorazi ka perceptuar çështjen penale.

Hetuesi që në fillim të çështjes penale, duhet të jetë i vetëdijshëm se njerëzit nuk perceptojnë në mënyrë të njëjtë, ata dallojnë sipas shumë cilësive, gjinisë, moshës, profesionit, invaliditetit etj. Kështu femrat perceptojnë më shumë imtësitat, hollësitë dhe kështu shqisat e tyre orientohen më shumë drejt ngjyrave dhe nuancave të shumta, ato i vërejnë kostumet dhe teshat, modelet dhe ngjyrat e tyre, i kushtojnë rëndësi rregullimit të flokëve, i vërejnë lulet, kopshtet, shtëpitë, numrin e targave të veturës, ngjyrën e veturës, si dhe shumë imtësira tjera, që janë të rëndësishme për zbardhimin e çështjes penale.

Kurse meshkujt perceptojnë ndryshe, ata shohin në vija të trasha, më tepër rëndësi u kushtojnë veturave si formë, objekteve të mëdha, etj. Pastaj njeriu percepton edhe në bazë të profesionit, përvojës etj., kështu piktori menjëherë do të vërente se piktura në mur qëndron shtrembët, elektrikisti do të vërente se dritat nuk janë në pozitë të drejtë, muratori murin e shtrembët e kështu me radhë. Kjo njihet edhe si *deformim profesional* sepse njeriu në bazë të profesionit që ka, ashtu edhe e orienton syrin dhe shqisat tjera, prandaj i vëren gabimet që të tjerët aspak nuk i shohin.

Por edhe përkundër këtyre karakteristikave, përsëri edhe njerëzit e gjinisë, moshës dhe profesioneve të njëjta, dallojnë në midis tyre. Aftësia e njeriu për të perceptuar njëkohësisht më shumë rrethana në botën e jashtme dhe të bëjë riprodhimin e tyre, njihet si *kapacitet simultan*.<sup>4</sup> Nga ky kapacitet varet se çfarë dëshmitari kemi në rastin konkret dhe sa është aftësia e tij për të perceptuar rrethanat që ndodhin pranë tij. Dëshmia e dëshmitarit edhe sot përkundër kritikave të shumta rreth vërtetësisë dhe sigurisë së dëshmisë, përsëri zë një vend të rëndësishëm në ndriçimin dhe sqarimin e veprave penale. Prandaj një nga metodat themelore në punën operative të policisë, për grumbullimin e të dhënave lidhur me një çështje penale, është biseda me qytetarët. Ligji mbi policinë i RM-së,<sup>5</sup> i jep kompetencë organit që të mund të thirr qytetarët dhe të zhvillojë biseda me ta.<sup>6</sup>

Këtu ende nuk është fjala për veprime procedurale apo për zhvillimin e procedurës penale, por për veprime operative, prandaj në këtë fazë, qytetarët sipas rregullativës ligjore, nuk kanë ndonjë obligim

<sup>4</sup> Батксока, Л., (2007), Криминалистичка Психологија. f.380.

<sup>5</sup> Neni 43, gazeta zyrtare e RM-së, nr.114/06.

<sup>6</sup> Shumica e qytetarëve të thirrur në polici, mendojnë se kanë detyrim ligjor të vijnë para organit policor dhe të dëshmojnë mbi atë që kanë parë ose dëgjuar ose të pyeten në cilësinë e të dyshuarit.

ligjor që të paraqiten para policisë, por sigurisht që është mirë të bashkëpunojnë me policinë lidhur me ndriçimin e veprave penale. Nëse qytetarët në këtë fazë policore, do të kishin obligim ligjor që të bashkëpunojnë me policinë, atëherë kjo do të nënkuptonte se ligji është ai që detyron qytetarët të bëhen bashkëpunëtorë të policisë (spiunë), që në shoqëritë demokratike vërtet nuk mund të lejohet. Por nga ana tjetër duhet të dihet se qytetarët nuk dëshirojnë dhe nuk kanë guxim të dalin në cilësinë e dëshmitarit, duke thënë se nuk e kam parë ngjarjen, nuk e kam dëgjuar, isha i kthyer në këtë anë, në atë anë etj., vetëm e vetëm që të mos dëshmojnë.

Prandaj puna e hetuesit është që ta bind personin se dëshmia është çështje hyjnore, është e shenjtë, pasi mundëson të mbrohet i pafajshmi dhe vetëm të paramendojmë, sikur ne të ishim në pozitën e viktimës. Te dëshmitari duhet të thyhet neutraliteti dhe indiferenca. Pas kësaj personi ftohet që të tregojë të gjithë atë që dinë lidhur me ngjarjen penale. Kur fillon të tregoj, atëherë nuk është mirë që të ndërpritet gjatë bisedës së tij, ai duhet të tregojë ngjarjen në kontinuitet, të gjithë atë që ka parë ose atë që ka dëgjuar. Por sigurisht që nëse dëshmitari del jashtë temës dhe vazhdimisht flet për gjëra të parëndësishme, atëherë në formë të butë duhet të rikujtohet lidhur me çështjen për të cilën është thirrur. Këtu parashtrahet pyetja, sa duhet të jetë numri i hetuesve që marrin pjesë në bisedë? Praktika ka treguar se dëshmitarët më mirë ndjehen kur në zyrë ka vetëm një hetues i cili me kujdes dëgjon atë çka thotë dëshmitari dhe ka pamje më të butë të fytyrës. Hetuesit me vija të ashpra të fytyrës, që duken të vrazhdë, nuk arrijnë rezultate të mira në intervistë, sepse në mes tij dhe palës shumë rëndë krijohet mirëbesimi. Po ashtu parashtrahet pyetja se a duhet marrë shënime deri sa zhvillohet biseda me dëshmitarin. Nuk ka dyshim se duhet të shënohet e gjithë ajo që thotë dëshmitari, por kjo do të jetë e mundshme vetëm nëse në zyrë janë të pranishëm dy hetues, kështu njëri me vëmendje e dëgjon dëshmitarin, kurse tjetri merr shënime. Nëse biseda zhvillohet vetëm nga një hetues, atëherë është mirë që hetuesi me kujdes të dëgjojë atë çka thotë dëshmitari, dhe në rastet të zbardhimit të rrethanave relevante ata shkurt mund të shënohen. Kur dëshmitari e përfundon thënien, atëherë hetuesi fillon me pyetje me qëllim që ta kompletoj dëshminë, sidomos nëse dëshmitari disa rrethana i ka lënë të pasqaruara. Në këtë drejtim, hetuesi duhet të pyes shkurtë, qartë dhe me përpikëri, pyetje të formuluar varësisht nga niveli intelektual i dëshmitarit. Pyetjet duhet të jenë të formuluar në atë mënyrë që të jenë plotësisht të kuptueshme dhe të



përbëjnë një tërësi logjike.<sup>7</sup> Hetuesi paraprakisht duhet të ketë mësuar për lidhjet eventuale në mes dëshmitarit dhe të pandehurit, kështu më lehtë do të mund të mësoj motivet që mund ta shtynin dëshmitarin të japë të dhëna të rrejshme p.sh: dashuria, miqësia, shoqëria, urrejtja, hakmarrja, korrupsioni, mendjelehtësia, frika, lavdërimi, dëshira për prestigj etj. Pastaj duhet verifikuar saktësisht nëse dëshmitari e ka parë ngjarjen apo për të, vetëm ka dëgjuar nga të tjerët. Gjatë zhvillimit të bisedës, hetuesi duhet të ketë parasysh edhe periudhën kohore që ka kaluar nga ngjarja, si dhe aftësitë e dëshmitarit të riprodhojë atë që ka parë.

Në shkencë ekzistojnë disa autorë që kanë tentuar ta llogarisin kohën dhe shpejtësinë e harresës pas ngjarjes.<sup>8</sup> Kështu sipas tyre, harresa fillon me shpejtësi të madhe menjëherë pas ngjarjes, sidomos në orët e para (58%), dhe pastaj harmonizohet duke u ngadalësuar sidomos gjatë ditës së dytë dhe të gjashtë. Pra, pas disa ditësh, personi ka humbur shumë rrethana të rëndësishme të cilët mund t'i zëvendësojë me përfytyrime dhe për këtë fare të mos jetë i vetëdijshëm. Kështu edhe Grassberger<sup>9</sup> konkludon se dëshmitari në përfundimin e ditës së dytë, pas ngjarjes kriminale mund të riprodhojë vetëm 1/5 të përjetimit të parë.<sup>10</sup> kurse pas një jave arrihet qëndrueshmëria relative me 10% nga ky përjetim. Edhe te riprodhimi koha është jetike, kështu sa më shpejt që bëhet riprodhimi nga ngjarja, aq më e plotë do të jetë ajo, prandaj hetuesi duhet pasur parasysh parimin e shpejtësisë. Por nga kjo rregull ka një përjashtim, kjo vlen për të dëmtuarit dhe dëshmitarët, që nga rasti kanë përjetuar tronditje shpirtërore. Tek ata, riprodhimi do të jetë më i mirë pas një ose dy ditësh.

Kjo dukuri njihet si *reminiscencë* që nënkupton çlodhjen e qelizave mendore, të cilat janë goditur nga reagimi emocional i personit.<sup>11</sup>

Nëse dëshmitari qëllimisht jep të dhënat të rrejshme atëherë mund t'i tërhiqet vërejtja për deklaratë të rrejshme. Si deklaratë e rrejshme do të konsiderohet ajo deklaratë me të cilën mohohen fakte të cilat janë të vërteta ose deklaratë me të cilën pohohen fakte që nuk janë të vërteta. Por edhe përkundër kësaj, nëse dëshmitari në fillim, gjatë bisedës së parë, nuk e thotë të vërtetën, megjithatë mbi hetuesin krijon përshtypje

<sup>7</sup> Latifi, V., (2009), *Kriminalistika*, Prishtinë, f.141.

<sup>8</sup> Водинелич, В., (1985), Откривање и Доказување, Shkup. f.71.

<sup>9</sup> Grassberger, R., (1968), *Psychologie des Strafverfahrens*, Vjenë. f.137.

<sup>10</sup> Водинелич, В., (1985), Откривање и Доказување, Shkup. f.71.

<sup>11</sup> Latifi, V., (2009), *Kriminalistika*, Prishtinë, f.130.

si një person i ndershëm dhe serioz që ka tipare të fuqishme të karakterit, të cilit mund t'i besohet, atëherë pas një periudhe të shkurtër (një-dy ditore), mund të ndodhë që dëshmitari përsëri ta thirr hetuesin dhe në një bisedë joformale t'i tregojë të gjitha rrethanat mbi ngjarjen. Prandaj, gjithmonë në fund të bisedës edhe nëse nuk kemi arritur rezultate të mira, nuk duhet të manifestojmë shenja të nervozizmit, por duhet të ndahen në mënyrë njerëzore si miq, të lënë hapësirë të takohen përsëri. Nuk duhet harruar që para se të ndahemi të ndërrojnë kontakt telefonat, apo t'i japim dëshmitarit vizitë kartelën, me shpresë që të paraqitet në një të ardhme të shkurtër.

#### 4.1. Biseda me fëmijë dhe të mitur

Në rolin e dëshmitarit shpeshherë paraqiten edhe fëmijët. Ata janë dëshmitarë të shumë çështjeve të rënda penale, sidomos dhunës në familje, vrasjeve, përdhunimeve, maltretimeve, torturës etj. Prandaj paraqitet nevoja që edhe fëmija të jetë dëshmitarë për atë që ka parë ose ka dëgjuar deri sa është kryer vepra penale.

Në të kaluarën ka mbizotëruar botëkuptimi se fëmija nuk mund të jetë dëshmitarë i mirë, por me kalimin e kohës sidomos me zhvillimin e shkencës së kriminalistikës, psikologjisë, defektologjisë, këto botëkuptime kanë ndryshuar dhe sot. Deklarata e fëmijës mund të jetë një provë shumë e fuqishme gjatë zhvillimit të procedurës penale.

Si edhe çdo deklaratë tjetër, ashtu edhe dëshmia e fëmijës mund të vlerësohen si e saktë dhe jo e saktë, e pavërtetë dhe e rrejshme.<sup>12</sup>

Por kur janë në pyetje fëmijët si dëshmitarë, atëherë duhet pasur kujdes për shkak të sugjestionit, fantazisë dhe zhvillimit më të dobët të menduarit tek fëmija. Po ashtu edhe strategjia e zhvillimit të bisedës nuk mund të jetë e njëjtë sikur me të rriturit. Tani duhet pasur një qasje krejt më të ndryshme krahasuar me të rriturit dhe hetuesi duhet ta njohë mirë psikologjinë e fëmijës.

Fëmijët kanë botën e tyre dhe gjuhën e tyre. Prandaj nga hetuesi kërkohet që ta njohë këtë botë dhe të gjejë mënyrën të depërtoj e të pranohet nga fëmija. Fëmijët kanë një sens natyror, që u mundëson menjëherë të vërejnë personat që i duan, që i lakmojnë si dhe personat që u duken të vrazhdë dhe i qortojnë. Mirëpo që të arrihet kjo, hetuesi duhet të dalë nga mosha e tij dhe të kthehet në moshën e fëmijës, pra të

<sup>12</sup> Sahiti, E., (1993), *Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale*, Prishtinë. f.184.

bëhet si ai, të luaje me lodra, me kukulla, t'i jap ëmbëlsira, e të bëjë gjeste që janë interesante dhe të pranueshme për të, vetëm në këtë mënyrë do t'i afroheni fëmijës.<sup>13</sup> Kjo bisedë duhet zhvilluar jashtë objekteve policore, por nëse zhvillohet në zyrë, atëherë zyra ku do të zhvillohet biseda duhet të ketë një atmosferë të këndshme, që fëmija posa të futet të ndjehet i rehatshëm dhe i lirë. Zyra duhet të ketë një numër të madh të lodrave, ngjyrave, vizatimeve, libra për fëmijë me lustrime, (fotografi) pas të cilave fëmija menjëherë do të tregoj interes dhe do të fillojë të luaj. Zyra nuk duhet të jetë klasike me karrige dhe tavolinë, por më tepër të duket si foshnjore apo çerdhe fëmijësh. Kjo zyrë nuk duhet të jetë në thellësi të objekteve policore, ku arrihet pas kalimit të korridoreve të gjata, apo labirinteve të shumta, sepse fëmijës këto korridore do t'i mbeten në kujtime për tërë jetën, prandaj është mirë që të adaptohet zyra e cila është në fillim të objektit. Në SHBA në rastet e pedofilisë dhe dhunimit të fëmijëve, FBI posedon zyrat e posaçme të adoptuara enkas për të zhvilluar biseda me fëmijët, aty ka lodra, kukulla, vizatime, ngjyra të shumta, me të cilat fëmija posa futet brenda ndjehet i kënaqur dhe menjëherë fillon të luaje me ta.

Bashkë me fëmijën luan edhe hetuesi i cili nëpërmjet të lojës, në mënyrë graduale, afrohet dhe krijon miqësi me fëmijën. Është e preferueshme që në rastet kur dëshmitari është djalë, atëherë hetuesi të jetë mashkull dhe anasjelltas, kur dëshmitari është vajzë edhe hetuesi duhet të jetë i gjinisë së njëjtë.

Pasi që vihen raportet miqësore dhe fëmija fillon të luajë, atëherë hetuesi fillon ta pyes fëmijën, p.sh: nëse është fjala për veprën penale të pedofilisë, ku vet fëmija ka qenë viktimë, atëherë hetuesi mundohet që nëpërmjet të kukullës, fëmija të tregojë me gisht për vendet ku është prekur ose vendet ku është goditur në rastet e dhunës në familje. Sigurisht se dëshmia mund të kombinohet duke folur e treguar me gojë për maltretimet, ofendimet, sharjet, torturat që i ka vërejtur ose i ka dëgjuar në shtëpi, kur prindi i dehur ka rrahur të ëmën dhe fëmijët e tjerë. Deri sa fëmija tregon për ngjarjen penale dhe orienton gishtin kah kukulla, video-kamera vazhdimisht incizon. Ky material më vonë shërben si provë në procedurën penale. Biseda me fëmijën nuk mund të zgjasë më shumë se 45 minuta, pastaj është e domosdoshme pauza. Këtu duhet të merret parasysh edhe mosha e fëmijës.

---

<sup>13</sup> FBI, (2012) Teknika e zhvillimit të Intervistës me fëmijë, seminar një javor i mbajtur në Idrizovë.

Fëmijët prej moshës 2 deri 4 vjet, shumë rëndë mund të merren si dëshmitarë, sepse kufijtë e vrojtimi dhe fantazisë i kanë shumë të luhatshtëm, por përsëri thëniet e tyre mund të merren me qëllim të orientimit në vende ku fshihen provat.

Mirëpo prej moshës 3 deri 4 vjet, fëmija mund të japë thënie të sakta, dhe mund të kenë fuqinë provuese në gjyq, megjithatë për shkak të moshës së vogël, thëniet e tyre më së shumti merren si prova orientuese.

Fëmija prej moshës 4-7 vjet, kalon nga zhvillimi i fantazisë dhe fillon sendet dhe dukuritë t'i perceptojë në mënyrë të drejtë, ashtu siç janë. Fëmija i kësaj moshe mundohet të njohë botën reale në të cilën jeton, prandaj mund të vërehet se ata janë shumë kureshtar dhe vazhdimisht pyesin dhe kërkojnë shpjegime për të gjitha çështjet që i rrethojnë, prandaj janë edhe shumë të mërztishëm për prindër. Por nuk duhet harruar se në këtë moshë të fëmija paralel zhvillohet edhe sugjestionimi prandaj dëshmia e tij, mund të jetë e ngatërruar edhe me imagjinatën.

Fëmija i kësaj moshe nuk ka kuptim të qartë për kohën, ai shpesh ngatërron të dhënat mbi periudhat kohore sot, dje, nesër etj.

Fëmijët prej moshës 7 deri 9 vjeç, mund të jenë dëshmitarë të shkëlqyer. Kurse pas kësaj moshe, e rëndësishme është gjinia, djemtë në moshën 10 vjeçare janë shumë të interesuar për të gjitha aktivitetet jetësore, ata i tërheq çdo gjë që tregon gjallëri, që ka dinamikë e motorik, që është aventuriere dhe që kërkon shpirt aktiv. Sipas disa kriminalistëve në këtë moshë, fëmija nuk dinë të gënjeje, ai është shpirt i pastër. Por çështja mund të jetë ndryshe te vajzat e kësaj moshe, tek ata më herët zhvillohen shenjat e pubertetit dhe nuk janë shumë të interesuara për botën që i rrethon, por për vetveten. Ata janë egocentrike dhe me orë të tëra qëndrojnë para pasqyrës, duke shikuar vetveten në prizma të ndryshme. Prandaj nuk janë shumë të mira për dëshmitare. Por edhe përkundër asaj që fëmija i kësaj moshe është shpirt i pastër, përsëri hetuesi duhet ta dijë se nga goja e fëmijës nuk del gjithmonë vetëm e vërteta (*Ex ore puerorum menpordacium*), por edhe gënjeshtër. Kështu Locard, iu kundërvu këtij mendimi duke thënë se nga goja e fëmijës del vetëm rrena.<sup>14</sup> Duhet marrë me rezervë të dy qëndrimet e skajshme sepse ka shumë çështje penale që janë ndriçuar në bazë të dëshmisë që ka dhënë fëmija. Shqisat e tyre janë të pashpenzuara, ndërsa vet janë të pangarkuar me problemet jetësore, janë të liruar nga paragjykimet dhe

<sup>14</sup> Latifi, V., (2009), *Kriminalistika*, Prishtinë, f.153.

animet.<sup>15</sup> Por kjo nuk do të thotë se fëmija nuk gënjen, prandaj duhet pasur parasysh se fëmija gënjen për t'u mbrojtur, për shkak të sugjestionit, nga përfitimi i të mirave etj. Por sidoqoftë edhe kur deklaratat e fëmijëve janë jo të sakta, ato duhet marrë si rrëfime jo të vërteta, e jo si rrenë. Fëmijët në këtë moshë (7-9 vjeçare) shumë pak mund të ndikohen nga faktorët shoqëror, ekonomik etj., sepse ata nuk janë të interesuar për pasurinë, por megjithatë rëndë mund të merret deklarata e fëmijës kundër prindit ose mësuesit pedofil, sepse në këtë moshë ata janë autoritetet më të fuqishme për fëmijën.

Fëmija si dëshmitarë më i mirë mund të jetë në moshën 12-15 vjeç. Në kriminalistikë është i njohur edhe *tipi eidetik i fëmijëve*. Eideza është aftësia apo kapaciteti simultan i fëmijës i cili ka aftësi të lartë të vrojtimit dhe të mbajturit mend. Kështu 1/3 e fëmijëve në moshën 12-13 vjet janë eidetik.<sup>16</sup> Më shpesh djemtë se vajzat-fotografinë e ngjarjes mund ta tregojnë aq qartë në bazë të memories, si të jenë duke e pasur ende para syve. Përshkrimi tyre përmban hollësi më të imta, të cilat i rrituri as që do t'i kishte vërejtur. Pikërisht për shkak të rrëfimit kaq të hollësishëm tek hetuesi mund të mbetet edhe përshtypja sikur fëmija e ka të kurdisur ngjarjen. Kjo mund të verifikohet në atë mënyrë që fëmijës i tregohen tri fotografi të ndryshme dhe pas 3-4 minutash kërkohet që të riprodhoj gjithë atë që ka parë. Kjo veti zakonisht zhduket pas moshës 15 vjeçare. Pas kësaj periudhe sidomos moshë e adoleshencës,<sup>17</sup> nuk janë shumë të mirë për dëshmitarë, kurse biseda me ta, ndryshon si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe nga qëndrimi i hetuesit. Tani më hetuesi nuk mund të jetë aq i afërt siç ishte më herët me fëmijët dëshmitarë. Por kjo nuk nënkupton që ai duhet të jetë i vrazhdë, prandaj nuk është mirë që të ngrihet zëri dhe të bërtitet me tonë të lartë, nuk duhet përkëdhelur i mituri, t'i jepet premtime, të luhet me të etj. Është mirë që i mituri dëshmitarë të silllet në vendin e ngjarjes dhe aty të sqarojë rrethanat për të cilët është thirrur.

Gjithashtu, të miturit ndikohen shpejtë, sidomos nga prindërit, prandaj nëse prindërit dëshirojnë që të ndikojnë te fëmija duhet të rrëfejë thënie të caktuara, atëherë mjafton ta tregojë ngjarjen para tij,

<sup>15</sup> Sahiti, E., (1993), *Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale*, Prishtinë, f.185.

<sup>16</sup> Vodinelić, V., (1996), *Kriminalistika*, Beograd, f.208.

<sup>17</sup> Fjala adoleshencë vjen nga latinishtja "adolescere" që d.m.th. rritem ose piqem. Kjo është periudha e shkurtër e jetës fillon në moshën 11-12 vjeçare dhe zgjat deri në moshën 18-19 vjeçare. Në këtë fazë njeriu pëson ndryshime të mëdha muskulore, sociale, emocionale, intelektuale etj. kjo është periudha kur njeriu nga fëmijëria kalon në të rritur.

ashtu siç duan ata. I mituri fillon të bindet se ngjarja ka ndodhur pikërisht ashti siç e tregojnë të rriturit.<sup>18</sup> Prandaj me të miturit është mirë që të bisedohet sa më shpejt, mundësisht menjëherë pas ngjarjes, nga se janë të ndikuar nga më të rriturit dhe menjëherë bien nën influencën e tyre. Pastaj në këtë moshë me kalimin e kohës i mituri shpejt e harron atë që ka parë, kurse rrethanat e vërteta zëvendëson me imagjinatën e tyre. Sidoqoftë në fund hetuesi duhet t'i analizoj thëniet e të miturit me sy kritik, por nuk është mirë që i mituri të thirret përsëri në bisedë, sepse deklarata e dytë do të jetë shumë më ndryshe nga e para, ajo tani do të zbulohet, kurse pjesët që i ka harruar, do t'i zëvendësoj me imagjinatën e tij.

Hetuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se të miturit nuk mund të bëjnë një tregim të lidhur, ai për shkaqe fizike dhe mendore duhet të përqendrohet për një kohë të gjatë dhe t'i kuptoj e t'i riprodhoj me saktësi rrethanat që ka parë ose ka dëgjuar në çastin e kryerjes së veprës penale. Nëse hetuesi konstaton se i mituri është i lodhur, duhet ta ndërpresë bisedën dhe ta vazhdojë më vonë. Pyetja me kohë të zgjatur deri në orët e vona është e dëmshme dhe e papranueshme për të marrë njoftime të sakta prej tij. Rreziku për të thënë gjëra krejt të paqena është i madh.<sup>19</sup> Pastaj duhet pasur parasysh edhe faktin se i mituri nga frika e hakmarrjes mund të marrë përsipër fajin sidomos në rastet kur bashkëpunëtorët e tij më të mëdhenj ose organizatori i grupit e kërcënon ose e bind se, nëse ata mbesin në liri, më vonë do ta nxjerrin atë nga burgu. Kështu i mituri duke dashur të tregoj lojalitet dhe heroizëm nuk tregon për organizatën.

## 5. Pyetja e të pandehurit

Duhet bërë dallimi në mes bisedës informative me të dyshuarin dhe pyetjes së të pandehurit. Në rastin e parë, fjala është për bisedë me personin kundër të cilit ekzistojnë vetëm bazat e dyshimit se është kryerës i veprës penale që nënkupton se kundër tij ende nuk zhvillohet procedura penale, e as që është paraqitur kallëzimi penal. Kurse pyetja e të pandehurit është veprim procedural dhe zhvillohet gjatë fazës së hetimeve në pajtueshmëri me dispozitat e LPP-së. Por nuk ka ndonjë dallim për sa i përket taktikës së zhvillimit të bisedës, pavarësisht se në cilën fazë zhvillohet ajo.

---

<sup>18</sup> Begeja, S., (1999), *Kriminalistika*, f.445.

<sup>19</sup> Po aty, f.446.

Kur është në pyetje zhvillimi i bisedës me të dyshuarin, atëherë kjo nënkupton se ai ende nuk është i arrestuar, prandaj kjo bisedë mund të zhvillohet edhe jashtë stacioneve policore, në shtëpinë e tij, në zyrën e tij dhe kudo tjetër, por kjo bisedë mund të zhvillohet vetëm në bazë të vullnetit të lirë të të dyshuarit, prandaj nëse i dyshuari refuzon të takohet me hetuesit, atëherë atyre nuk ju mbet asgjë tjetër përveç që provat t'i sigurojnë me metoda të tjera të ligjshme. Me këtë rast dëshiroj të përmend se praktika e policisë në vendet tona, që i dyshuari kundër të cilit ekziston bazat e dyshimit, të thirren në stacionet policore që të zhvillohen biseda me të është tepër negative, prandaj duhet ndjekur praktika e shteteve tjera, sidomos SHBA-së, Anglisë, Gjermanisë, etj. Në këto vende policia me qytetarët dhe me të dyshuarin kontakton jashtë objekteve policore, (në shtëpitë e tyre, vendet e punës etj.) dhe kjo mënyrë e punës është më e preferuar. Nga ana tjetër, thirrja e të dyshuarit në stacionet policore, mbi bazat e dyshimit, implikon që ai të ndjehet i poshtëruar, të ndjehet i arrestuar dhe i kufizuar në lirinë e tij. Nuk ka dyshim se çdo njeri, me rastin e pranimit të thirrjes me të cilën thirret në stacionin e policisë, nuk qëndron indiferent, ai fillon të ndjehet i trishtuar e i pasigurt, emocionalisht i shokuar. Prandaj në fillim të hetimeve nuk duhet thirrur të dyshuarin në stacionet policore, deri sa të sigurohen prova mbi dyshimin e bazuar. Prandaj në këtë fazë hetuesit i mbetet që me të dyshuarin të takohet jashtë objekteve policore edhe atë vetëm në cilësinë e qytetarit, pa asnjë formalitet dhe obligim ligjor. Nga këto biseda si zakonisht hetuesi mund të përfitoj informacione të karakterit të përgjithshëm, prandaj këtu nuk bëhet fjalë për pyetjen e të dyshuarit.

Marrja në pyetje e të pandehurit bëhet për shkak të rëndësisë që ka deklarimi dhe pohimi i tij si provë për ndriçimin dhe zgjidhjen e çështjes penale. Është evidente se asnjë e drejtë, si në të kaluarën ashtu edhe sot, për shkak të rëndësisë që ka deklarimi i të pandehurit, nuk ka mundur krejtësisht të heqë dorë nga marrja e tij në pyetje. Kjo për arsye se të pandehurit më së miri i është e njohur se a është kryerës i veprës penale apo jo. Në anën tjetër, organet procedurale nuk disponojnë gjithmonë me mjaft prova të tjera me të cilat do të ndriçohet çështja penale, sepse sa më e rëndë që është vepra penale, aq më tepër i pandehuri kujdeset që t'i eliminoj provat, prandaj organet procedurale janë të orientuara edhe në deklarimin e të pandehurit.

Megjithatë, organet procedurale nuk duhet ta konsiderojnë të pandehurin si burim kryesor për të dhënat e nevojshme për zbardhjen e

veprës penale dhe të përgjegjësishë penale të tij.<sup>20</sup> Gjatë marrjes në pyetje, të të pandehurit duhet t'i bëhen pyetjet qartë, kuptueshëm dhe me përpikëri, ashtu që ai t'i kuptojë plotësisht. Me këtë rast nuk duhet t'i bëhen pyetje kapcioze e as sugjестive. Pyetja kapcioze nënkupton formulimin e pyetjes asisoj që me rastin e formulimit të saj, pyetësi nisat nga supozimet se i pandehuri ka pohuar diçka që në realitet nuk e ka pohuar. Pyetje sugjестive është ajo pyetje e cila në veti përmban atë se si duhet përgjigjur.<sup>21</sup> Gjatë zhvillimit të bisedës me të dyshuarin, hetuesi është shumë aktiv thuat se 95% të bisedës e zhvillon ai, kurse vetëm 5% i dyshuari. Por në qoftë se gjatë këtyre bisedave, i dyshuari në bazë të vullnetit të lirë, tregon provat, atëherë sigurisht që ato mund të shërbejnë si prova për të akuzuar atë. Në rastet kur hetuesi ka grumbulluar mjaftë material për të akuzuar të dyshuarin, atëherë ai mund ta thirr ose ta arrestoj të dyshuarin dhe pastaj të fillohet me intervistën ose me pyetjen e të dyshuarit. Edhe me të dyshuarin kundër të cilit ekziston dyshimi i bazuar dhe i njëjti është i arrestuar, hetuesi duhet të ketë sjellje të mirë e humane. Ai duhet të pritët mirë, pavarësisht krimit që ka bërë dhe menjëherë, pa shtyrje të njoftohet me të drejtat ligjore. Këto të drejta në SHBA janë të njohura si rregullat e Mirandës.<sup>22</sup> Hetuesi duhet ta trajtojë të dyshuarin në mënyrë njerëzore, ta respektojë dinjitetin e tij, prandaj sa herë që është e mundur, nëse është i prangosur duhet hequr prangat që ai të ndjehet i lirë dhe komod. Hetuesi duhet të ketë parasysh se i dyshuari i vërtetë është personi që më së miri e dinë se çfarë ka ndodhur, ku janë provat, me cilët mjete e ka kryer veprën dhe shumë rrethana të tjera relevante për ndriçimin e veprës penale. Prandaj duhet të ketë sjellje të mirë dhe të jetë i vetëdijshëm për thënien se “*Më shumë miza kapen me sheqer, se me acid*”, ose “*Fjala e ëmbël, hapë,*

<sup>20</sup> Sahiti, E. & Zejneli, I., (2007), *E Drejta e Procedurës Penale e Republikë së Maqedonisë*, Tetovë, f.192.

<sup>21</sup> Po aty, f.194.

<sup>22</sup> Ernesto Miranda ishte një emigrant meksikan që jetonte në Phonix të Arizonës në SHBA. Ai nga policia e shtetit u akuzua për vepër penale të përdhunimit. Pasi ishte arrestuar nga policia, me të ishin zhvilluar biseda informative, por nuk ishte njoftuar me të drejtën e heshtjes dhe të drejtën e mbrojtësit. Ky rast më vonë arriti deri në gjykatën supreme të SHBA-së, e cila mori vendim se Ernesto Mirandës, nuk i ishte dhënë e drejta e heshtjes, edhe pse ai kishte nënshkruar formularët se nuk do të hesht dhe se nuk dëshiron avokat, përsëri gjykata konstatoi se, në fakt ai nuk e kishte kuptuar se çfarë nënshkruan. Me këtë rast gjykata supreme vendosi që hetuesit janë të obliguar që të arrestuarve t'u japin të gjitha të drejtat ligjore, pavarësisht nga statusi i tyre social, kurse intensiteti i zërit të hetuesit duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për të drejtat, pa mos krijuar asnjë konfuzitet tek i arrestuari.



*dyert e hekura*".<sup>23</sup> Edhe këtu parashtrohet pyetja sa duhet të jetë numri i hetuesve gjatë zhvillimit të intervistës apo bisedës informative. Për dallim nga dëshmitari, këtu duhet të marrin pjesë dy hetues. Por ata para se të fillojnë bisedën, duhet të bëjnë përgatitjet e nevojshme: të zgjedhin vendin se ku do të zhvillohet biseda, karrigia ku do të ulet i dyshuari, largimi i pengesave (tavolinës) në mes hetuesit dhe të dyshuarit dhe të përmbushë kushtet që përmendëm më lartë.<sup>24</sup>

Punëtorët operativ duhet të jenë të organizuar dhe të koordinuar, ata tani më duhet të kenë ngritur konceptin e pyetjeve që duhet të sqarohen gjatë intervistës, të jepet përgjigje në pyetjet e arta të kriminalistikës dhe kuptohet, të arrihet qëllimi i pyetjes, e kjo është marrja e deklaratës apo pohimi i të dyshuarit, me të cilën pranon autorësinë e veprës penale. Derisa te biseda me të dyshuarin kundër të cilit ekzistojnë vetëm bazat e dyshimit, roli i hetuesit është shumë aktiv, tani është e kundërta, hetuesit vetëm parashtrojnë pyetje të shkurtra dhe qëndrojnë pasiv, kurse i dyshuari jep sqarime të hollësishme mbi rrethanat relevante. Prandaj tani ndryshojnë rolet në mes të hetuesit dhe të dyshuarit, tani 95% e bisedës i takon të dyshuarit, kurse hetuesit 5%, vetëm kur parashtron pyetje.

Përveç rregullave që përmendëm më lart lidhur me qëndrimin e hetuesit, parashtrohet edhe pyetja: sa duhet të jetë distanca në mes hetuesit dhe të dyshuarit, gjatë zhvillimit të intervistës? Dr. Edwardu T. Hallumendon se njerëzit përveç se janë qenie shoqërore, janë edhe qenie territoriale, secili ka zonën e vet hapësinore, gjatë së cilës komunikon me tjerët.

Ai ka përcaktuar katër zonat hapësinore edhe atë: zona intime, zona personale, zona shoqërore dhe zona publike.<sup>25</sup>

*Zona intime* përfshin distancën prej pikës së kontaktit të trupit të personit fizik, deri në 47 cm. Në këtë zonë personi ka dominim fizik dhe lejon të hyjnë vetëm më të afërmit e tij. Pra siç shihet kjo zonë është

<sup>23</sup> Ka raste kur i dyshuari lidhet për kasaforte apo për gypat e nxehtë, që vërtet le një pamje poshtëruese dhe jo humane, kurse hetuesit tjerë dalin në zyrën tjetër dhe fillojnë ta godasin murin, tavolinën, byrotë, duke bërë titur se gjoja dikush torturohet në zyrën tjetër, që të shkaktoj frikë tek i dyshuari dhe kështu të nxitet bashkëpunimi dhe ta pranojë veprën penale.

<sup>24</sup> Nëse në vendin ku do të zhvillohet biseda ka zhurmë, atëherë ajo nuk do të jetë e suksesshme.

<sup>25</sup> Nathan, G. & William, F., (2002), *Effective interviewing and interrogation techniques*, Sarajevë, f.12.

shumë afër nesh që ende mund të prekim me dorë prandaj secili e llogarit si territor të vet.

*Zona e dytë (zona personale)* përfshin distancën që shtrihet prej 47 cm. deri 1.3 m. Kjo distancë është jashtë mundësisë së të prekurit dhe këtu humbet dominimi fizik, por për hetuesin kjo është distanca e nevojshme që duhet mbajtur gjatë zhvillimit të bisedës. Pra largimi i hetuesit prej të dyshuarit duhet të jetë diku 1.3 m., por në rastet kur vëren se i dyshuari humb koncentrimin, atëherë hetuesi qëllimisht mund të futet edhe në zonën intime që të shkaktojë reagim refleksiv të brendshëm dhe ta kthej koncentrimin e të dyshuarit në bisedë. Çdo ndërhyrje në zonën intime mund të rezultoi me dhënien e deklaratës mbi pohimin e veprës penale. Kurse personi që nuk është fajtor, ai do ta shpreh indinjatën e thellë për veprimet e hetuesit që futet në zonën e tij intime.

*Zona e tretë (zona shoqërore)*, shtrihet në distancën prej 1.3 deri në 2.13 m., në këtë distancë zhvillohen shumica e bisedave tona joformale, sidomos në distancë prej 1.3 cm deri në 2.13. Kjo është zona territoriale kur përshëndetemi me miqtë (shtrim dorën njëri - tjetrit), dhe në këto pozita mbesim gjatë bisedës.

*Zona e katërt (zona publike)*, shtrihet në mes 2.13 deri në 7 m., e më shumë dhe këtu si zakonisht mbahen bisedat publike para popullatës.<sup>26</sup>

Përveç rëndësisë së distancës e rëndësishme është rregullimi zyrës, sidomos karriges ku do të ulet i dyshuari, është mirë që në mes hetuesit dhe të dyshuarit të mos ketë tavolinë. Kështu mungesa e pengesave në mes tyre e bën që biseda të jetë më miqësore dhe më e afërt.

Hetuesi tani më duhet t'i ketë të gatshme të gjitha pyetjet e arta të kriminalistikës të cilave duhet t'u jepet përgjigje gjatë bisedave me personin. Pyetjet duhet të jenë të formuluar në atë mënyrë që të jenë të qarta dhe saktësisht të dihet se çfarë përgjigjesh duhet marrë. Pyetjet në përgjithësi ndahen në dy grupe, pyetjet relevante dhe irelevante. Pyetjet irelevante kanë të bëjnë me të dhënat mbi personin e dyshuar, me biografinë e tij, kurse pyetjet relevante kanë të bëjnë direkt me rrethanat relevante të lidhura me veprën penale. Hetuesi intervistën e fillon me pyetjet irelevante, që të relaksohet pak i dyshuari. Pasi fillon biseda, njëri nga hetuesit i cili zhvillon bisedën, me kujdes dhe koncentrim të plotë e dëgjon të dyshuarin, kurse tjetri shkruan atë që thotë i dyshuari,

<sup>26</sup> Po aty, f. 24.

por nuk duhet shkruar e gjitha, por vetëm ajo që është më e rëndësishme. Hetuesi i mirë menjëherë do ta vërej të dyshuarin i cili renë, edhe pse ai është përgatitur dhe e ka krijuar gënjeshtren, përsëri nuk mund të jetë i përkryer, dhe të dijë gjithë atë çfarë do ta pyes hetuesi. Prandaj që në fillim të bisedës, mund të vërehet se i dyshuari që renë, jep përgjigje të shkurta, pa detaje dhe është shumë i pasigurt gjatë të folurit, ka ndërprerje, kthehet përsëri që t'i sqarojë disa rrethana etj. Hetuesi që zhvillon bisedën, por edhe ai që shkruan vazhdimisht, duhet të ndjekin jo vetëm komunikimin verbal, atë që thotë i dyshuari, por edhe lëvizjet trupore dhe ndryshimet psiko-fizike që bëjnë pjesë në të ashtuquajturin komunikim joverbal. Domosdo duhet ndjekur reagimet e të dyshuarit dhe të përcillen ndryshimet psiko-fizike apo reaksionet që ndodhin tek ai deri sa flet mbi ngjarjen. I dyshuari që mund të jetë fajtor, si zakonisht gjatë bisedës ka një reagim më të butë, është i përmbajtur dhe në asnjë mënyrë nuk dëshiron të hidhëroj hetuesin.<sup>27</sup>

Shikimi tij nuk është i drejtuar kah hetuesi, por në vende tjera. Megjithatë duhet pasur parasysh se kur intervista zhvillohet me kriminelë që kanë përvojë dhe karrierë të gjatë kriminale, atëherë ato i mbajnë sytë drejtë hetuesit, duke dashur në këtë mënyrë të tregojnë se janë të pafajshëm. Prandaj edhe hetuesi duhet të mbajë shikimin drejt të dyshuarit dhe të shikoj në sy, në asnjë mënyrë nuk duhet lëshuar sytë poshtë para të dyshuarit, sepse ai këtë do ta nënkuptonte si kapitullim të hetuesit.<sup>28</sup> Për dallim nga ky, i dyshuari i pafajshëm, gjatë bisedës është i mllëfosur, ai është i hidhëruar dhe shikimin e mban drejt hetuesit. Këtu duhet pasur kujdes kur i dyshuari gjatë zhvillimit të bisedës del nga konteksti i rastit dhe vazhdimisht përmend se nuk është fajtori, sepse tek ai mund të përforcohet bindja e tillë dhe pas kësaj shanset janë të vogla që ta pranojë fajin, prandaj hetuesi në këto momente duhet të reagoj, të ndërpres dhe të kthej të dyshuarin aty ku ka mbetur me rrëfimin. Si zakonisht i dyshuari i pafajshëm vazhdon të bisedojë më hetuesin duke tentuar ta bind në pafajësinë e tij. Nëse hetuesi edhe më tej vazhdon me akuzat ndaj të pafajshmit, atëherë mund të ndodhë që ai të ngrihet në këmbë, të filloj të bërtas, ndodhë edhe t'i afrohet hetuesit deri në zonën personale, duke nxjerrë hidhërimin e vet ndaj akuzave të pabazuara. Kurse i dyshuari i vërtetë, tërhiqet, izolohet dhe mbrohet me

<sup>27</sup> Doracak i OSBE-së, (2013), *Teknika e zhvillimit të intervistës me të dyshuarin*, Shkup, f.43.

<sup>28</sup> Nathan, G. & William, F., (2002), *Effective Interviewing & Interrogation Techniques*, Sarajevë, f.23.

heshtje. Po ashtu si lëvizje tjetër joverbale që bën i dyshuari gjatë intervistës, që duhet pasur parasysh hetuesi është edhe ajo që, nëse gjatë të folurit i dyshuari shpesh kollitën, prekën gishtat, kafshon buzët, merr frymë thellë, të gjitha këto janë simptome që ai gënjen. I dyshuari që është fajtor, në mënyrë të pavetëdijshme i përsërit këto gjeste, sepse këto lëvizje i ndihmojnë që të stabilizohen dhe të fitojnë në kohë, deri sa të përfundojnë me gënjeshtren e vet. Hetuesi, po ashtu duhet të vërej edhe lëvizjen e këmbëve tek i dyshuari, nëse ai gjatë bisedës pa ndalur i lëviz këmbët, i luhatën me ritëm të shpejtë, nuk është stabil, këto janë simptome që hetuesi duhet t'i ketë parasysh si tregues të gënjeshtres. Po ashtu nëse gjatë zhvillimit të bisedave, i dyshuari tre herë ndërron pozitën e këmbëve, hedh njërën përmbi tjetrën, pastaj përsëri i kthen në gjendjen e mëparshme, kjo është indikacion i fuqishëm që ai gënjen, sepse njeriu që nevrifikoset për shkak të gënjeshtres, ai nuk është i rehatshëm, andaj nuk mund të qëndrojë i qetë. Karakteristikë tjetër që hetuesi duhet ta ketë parasysh është edhe ajo se, nëse i dyshuari gjatë bisedës prek hundën, atëherë hetuesi duhet që atë pjesë të bisedës të ketë kujdes dhe ta merr me rezervë, sepse i dyshuari në atë mënyrë dëshiron të jetë më bindës, duke tentuar të bëjë një pamje naive të fytyrës. Me interes është edhe nëse i dyshuari pa ndalur e prek syrin, ai kështu mundohet të dekoncentroj hetuesin dhe të jetë më pak i interesuar për të vërtetën. Është mirë që para të dyshuarit, në vendin ku do të ulet, të vendoset një stilolaps ose ndonjë send i vogël, kështu që i dyshuari që është fajtor menjëherë do ta marrë dhe do të fillojë që ta rrotullojë nëpër gishta, për shkak të jostabilitetit shpirtëror, kurse i pafajshmi do ta marrë dhe thjesht do ta largojë anësh, duke mos manovruar me të. Tepër e rëndësishme është të shihet nëse të dyshuarit gjatë zhvillimit të bisedës i thahet goja, kjo është indikator i fuqishëm që ai gënjen, sepse kur njeriu gënjen, pëson ndryshime fiziologjike dhe vjen deri tek tharja e gjëndrave pështymore. E gjithë kjo që u përmend më lart, kuptohet vetëm mund t'i ndihmojë hetuesit që të ketë një orientim më të mirë, por asnjëherë nuk mund që vetëm lëvizjet e të dyshuarit të shërbejnë si prova.

Praktika në mënyrë shumë bindëse na ka mësuar se nuk ka të dyshuar i cili nuk përgatitet për bisedë, për atë se çka do të thotë para organit hetues, por edhe hetuesi është i vetëdijshëm për këtë fakt. Nga ana tjetër, sado që i pandehuri të përgatitet, përsëri thënia e tij nuk mund të jetë ideale, ai do të mundohet të sqarojë rrethanat në mënyrë bindëse, por përsëri do të vërehen gabime teknike, taktike dhe logjike. Prandaj në disa raste edhe vet i dyshuari derisa jep deklaratën, vetvetiu i vëren

palogjikshmëritë dhe tenton të kthehet përsëri, që t'i përmirësoj gabimet e bëra. Këto momente lehtësisht mund të vërehen nga hetuesi dhe mund të shërbejnë si kapitullim i të pandehurit para tij. Në rast të dhënies së deklaratës me të cilën i pandehuri e pranon veprën penale, zëri fillon t'i zbehet, përcillet me ton më të butë dhe bëhet shumë i ndjeshëm. Po ashtu të pandehurit, fillon t'i thahet goja, kurse në skaje të buzëve mund të vërehet shkuma e bardhë. Kjo gjendje emocionale përcillet edhe me ndryshimin e ritmit të frymëmarrjes, ku procesi i frymëmarrjes fillon të dobësohet dhe bëhet edhe më i thellë. Hetuesi duhet të ketë kujdes dhe të vërej momentin kur i pandehuri fillon të qajë,<sup>29</sup> ky është kulmi i deklaratës, prandaj duhet veçuar si pjesën më të rëndësishme të pohimit. Gjatë kësaj periudhe deri sa i pandehuri folën, ndodh të nxjerrë faculetën e të fshi lotët, djersët, fillon të kërcas gishtat, bëhet tkurrja e muskujve etj. Pas dhënies së deklaratës, fillon të shpejtohet procesi i frymëmarrjes, kurse koka (mjekra), automatikisht lëshohet poshtë gjoksit. Për një moment më nuk është në gjendje që të vazhdojë bisedën, prandaj kërkon që të pije ujë apo ndonjë cigare. Në këto raste hetuesi duhet t'i jap përkrahje morale të pandehurit, duke i thënë se ju jeni njeri i drejtë, por ja që ka ndodhur rasti, por çdokush që do të ishte në pozitën tuaj do të vepronte njësoj si ju.<sup>30</sup> Pas dhënies së deklaratës, personi qetësohet dhe më nuk mund të vërehen emocionet dhe ndjenjat sepse tani vjen deri tek shuarja e tyre. Një gjendje e këtillë, tregon se i pandehuri ka dhënë deklaratë të sinqertë.<sup>31</sup> Në qoftë se i pandehuri nuk qetësohet pas dhënies së deklaratës, atëherë mundësia që thënia të jetë e rrejshme është e madhe, prandaj në këto raste deklarata duhet pranuar me rezervë. Mirëpo është interesant se, pasi kalon faza parapenale dhe fillon seanca kryesore, i pandehuri tërheq deklaratën e tij, duke thënë se policia i kishte bërë trysni që të jepte deklaratë kundër vetvetes dhe nga frika që të mos torturohet. Kjo si zakonisht ndodh në rastet kur kryerësi e kupton se organi hetues nuk ka provë tjetër, përveç deklaratës së tij. Organi hetues asnjëherë nuk duhet të kënaqet vetëm me deklaratën e të pandehurit sepse e di që nën ndikimin e mbrojtësit deklarata e dhënë mund të mohohet, prandaj duhet të sigurohen edhe provat të tjera materiale. Kur sigurohen këto prova, atëherë hetuesi e ka lehtë që të pyes të pandehurin. Sipas disa kriminalistëve, hetuesi në këtë rast duhet të luajë me letrat e hapura, bile gjatë intervistës së parë i pandehuri

<sup>29</sup> Крстич, О., (1995), *Откривање Лажи*, Београд, f.147.

<sup>30</sup> Roso, Z., (1995), *Informativni razgovor i intervju*, Zagreb, f.153.

<sup>31</sup> Симунович, Б., (2004), *Криминалистика*, Крагујевац, f.223.

duhet njoftuar me tërë materialin provues.<sup>32</sup> Sipas disa të tjerëve, hetuesi nuk duhet që menjëherë në fillim të intervistës, ta njoftojë të pandehurin me materialin provues, por ajo duhet bërë shkallë-shkallë.<sup>33</sup> Praktika tregon se më mirë është që njëherë në fillim të pyetet i pandehuri me materialin provues, thënia e tij të shënohet në procesverbal dhe pastaj të ballafaqohet me provat. Nëse p.sh: hetuesi në fillim të intervistës i thotë të pandehurit se *gjurmët e gishtave tuaj janë gjetur në vendin e ngjarjes*, atëherë ka shumë mundësi që kryerësi t'i thotë se para disa ditësh kishte qenë në atë vend dhe ndoshta atëherë i ka lënë gjurmët. Prandaj, para se të njoftohet i pandehuri me materialin provues, duhet tërthorazi të pyetet p.sh: nëse eventualisht më parë kishte qenë në vendin e ngjarjes, kurse përgjigja e tij menjëherë shënohet në procesverbal.<sup>34</sup> Në praktikë janë të njohura rastet kur i pandehuri e ka pranuar veprën penale, me qëllim që të fsheh një vepër tjetër më të rëndë penale.<sup>35</sup>

## Conclusion

Regarding the importance of criminalistics interview with suspected person, witnesses and victims during police procedures are very important. In our country the statement given before police officer is not proof, but however this is very important to provide fair investigations. In this way, its better police officers to have enough knowledge about techniques and tactics how to develop interview especially with suspect persons. This can be achieved through education and training te police officer, who would have knowledge of psychological development occurring in the human body. In Great Britain where common law the legal system differs from all European states, the suspect person is not obliged to answer to the police questions, but if he confest guilty, then this is worth to use like a proof before jugde in the trial. But all the conversation is fixed with a record end its very importen the person to signs the statement. All investigators how had had a lot of experience with investigate, know that the interview its very important things, especially at the beginning of the police procedure, therefore is

<sup>32</sup> Ransiek, A., (1990), *Die Rechte des Beschuldigten in der Polizeivernehmung*, Berlin, f.16.

<sup>33</sup> Löwe - Rosenberg, (1984), *Grosskommentar stop*, Berlin, f.337.

<sup>34</sup> Алексић, Ж., (1972), *Научно откривање злочина*, Београд, f.145.

<sup>35</sup> Ачимовић, М., (1987), *Психологија злочина и суђења*, Веоград, f.279.

necessary to have good behavior with suspected person. He knows more than everyone else, but information will be taken with good behavior. Remember the insect caught with sugar, non with acidic.

### Bibliografia

- Abadinsky, H., (1994), *Organized Crime*, Chicago.
- Alison, C., (1973), *Personal Identification*, Boston.
- Adams, T.F., (2004), *Crime scene investigation*, Prentice Hall, Upper Saddle River.
- Aleksić, Ž., (1994), *Kriminalistika*, Beograd.
- Alderson, J., (1995), *Ljudska prava i policija*, Rijeka.
- Ačimović, M., (1978), *Psihologija sudenja i zlocina*, Beograd.
- Алексоски С., (2005), *Психологија со криминалистичка психологија*, Shkup.
- Ангелески, М., (2007), *Вовед во криминалистика*, Shkup.
- Ангелески, М., (2007), *Криминалистичка тактика*, Shkup.
- Avziu, Q., (2014), *Justicia, Nr.2*, Tetovw.
- Bayer, V., (1943), *Kazneno Pustopovno Pravo*, Zagreb.
- Bayley, D., (1995), *Police for the Future*, Oxford University Press, New York.
- Barry, A. F.- David, R.F., (2012), *Crime scene invstigation*, Los Angeles.
- Barry, M. B., (2006), *Becoming a Police Officer*, Shkup.
- Batalli, F., (1987), *Mjeksia Ligjore*, Prishtinë.
- Batolska, L. (2007), *Kriminalistika Psihologija*, Shkup.
- Batkovski, T., (2008), *Taktika na Razuznavanje, Bezbednost i Kontrarazuznavanje*, Shkup.
- Bačić, F., (1995), *Krivicno Pravo*, Zagreb.
- Begeja, S., (2001), *Kriminalistika*, Vëllimi I, II. Tiranë.
- Begeja, S., (1998), *Bazat shkencore të oragnizimit dhe të hetimit të veprave penale*, Tiranë Bajgora, A., (1998), *Krimet kundër lirive dhe të drejtave në Kosov*, Prishtinë.
- Bošković, M., (2000), *Kriminalistika*, Beograd.
- Bošković, M., (1998), *Organizovani Kriminalitet*, Beograd.
- Brandl, S. G., (2004), *Criminal Invastigation-an analytical perspective*, Boston.
- Byrd, m., (2001), *Crime scene evident*, Wildomar.

- Çipi, B., (2011), *Identifikimi i Personit*, Tiranë.
- Damaška, M., (1962), *Okrivljenikov iskaz kao dokaz u suvremenom krivinom procesu*, Zagreb.
- Demolli, H., (2002), *Terrorizmi*, Prishtinë.
- Doracak i OSBE-së. (2013), *Teknika e zhvillimit të intervistës me të dyshuarin*, Shkup.
- Dimitrijevic, V., (1985), *Strahovlada*, Beograd.
- Dimitrov, D., (1995), *Policiski Informatori*, Shkup.
- Dragoti, E., (1999), *Adoleshenti*, Tiranë.
- Elezi, I., (2002), *E drejta penale*, pjesa e posaçme, Tiranë.
- Elezi, I., (2000), *Vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje në Shqipëri*, Tiranë.
- Elezi, I., (1999), *Mendimi Juridik Shqiptar*, Tiranë.
- Eliot, M., (1962), *Zlocin u suvremenom drustvu*, Sarajevë.
- Fetahu, A., (1996), *Diskriminimi në punë dhe profesion*, *Revista E Drejta*. 3-4. Prishtinë.
- Филип, P., (2009), *Транснационален криминал и правда*, Shkup.
- Gashi, R., (2001), *Ekzekutimi i dënimit me burg në Shqipëri*, Tiranë.
- Gross, H., (1905), *Kriminalpsychologie*, Barth Verlag, Leipzig.
- Gross, H. – Geerdts, F., (1978), *Handuch der Kriminalistik*, Berlin.
- Grasberg, R., (1968), *Psychologie des Strafverfahrens*, Vienë.
- Goldstein, H., (1990), *Community Policing and Problem Oriented Policing*, New York.
- Gordner, G., (2001), *Community Policing Elements and Effects*, New York.
- Hajdari, A., (1998), *Krimet e luftës kundër popullsisë civile në Kosovë*, Prishtinë.
- Herbert, D.L., & Sinclair, V.L., (1977), *The Use of Minors as Undercover Agents or Informants*, *Journal of Police Science and Administration*, New York.
- Halili, R., (2011), *Kriminologjia*, Prishtinë.
- Hasan, Sh., (1996), *Historia e Policisë*, Tiranë.
- Hoxhati, F., (2000), *Flagranca dhe Procesi Penal*, Tiranë.
- Hoyts, M., (1958), *From evidence to proof*, Springfield.



- Ikonomi, V., (2004), *Metodat Moderne në ekspertimin Kriminalistik*, Tiranë.
- Jatkowski, W., (1979), *Korišćenje latentih otisaka rukavica kao materijalni dokaz*, Izbor, nr.4, Zagreb.
- Johanson, H., (1996), *Hystori of Criminal Justice*, Cincinnati.